



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Nr. 431/2021
Datë: 05.08.2021

Në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, në përputhje me dispozitat e nenit 8, paragrafit 1.4. të Rregullores (QRK) Nr.02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M
mbi

caktimin e kushteve dhe kriterëve për zbatimin e masës 1.3 - Mbështetja e Punësimit të Grave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike

A. FORMA E SUBVENCIONIMIT

1. Mbështetja e Punësimit të Grave bëhet në format si në vijim:
 - 1.1. Subvencionim i pagës deri në 50% (pesëdhjetë për qind) të pagës bruto mujore për 3 (tre) muaj.
 - 1.2. Pas përfundimit të periudhës tremujore sipas nën-paragrafit 1.1, do të subvencionohen kontributet pensionale për muajt e mbetur, konform kriterëve dhe kufizimeve të përcaktuara me vendimin për zbatimin e masës 1.2 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve nr. 40/2021, të datës 29.07.2021.

B. KRITERET PËR SUBVENCIONIM

2. Subvencionimi sipas këtij vendimi bëhet vetëm ndaj atyre punonjësve që:

2.1.Në muajin qershor të vitit 2021 kanë qenë të papunësuar dhe/ose të padeklaruar për qëllime tatimore në sistemin e Administratës Tatimore të Kosovës;

2.2.Punësohen dhe deklarohen për qëllime tatimore në Administratë Tatimore të Kosovës nga muaji korrik 2021 e tutje dhe atë brenda afatit të përcaktuar ligjor; dhe

2.3.U paguhet obligimi tatimor dhe kontributet me rastin e punësimit dhe deklarimit.

C. KOHËZGJATJA E SUBVENCIONIMIT

3. Subvencionimi realizohet prej momentit të punësimit dhe deklarimit për qëllime tatimore në sistem të Administratës Tatimore të Kosovës *i.e.*, akti i formalizimit, jo më herët se muaji korrik 2021, dhe gjer në muajin qershor të vitit 2022.

D. KUFIZIMET NË SUBVENCIONIM

4. Subvencionimi i pagës nuk mund ta tejkalojë shumën 170 (njëqind e shtatëdhjetë) Euro bruto për punonjës, pavarësisht pikës 1.1 të këtij vendimi.

E. NDËRPRERJA E SUBVENCIONIMIT

5. Subvencionimi për punonjës të specifik ndërprehet në momentin e pushimit të marrëdhënies së punës për çfarëdo arsye dhe largimit nga lista e të punësuarve në deklaratën e tatimpaguesit, dhe/ose nuk ju paguhen obligimet tatimore.
6. Subvencionimi ndërprehet në rastin kur punëdhënësi nuk i paguan kontributet pensionale, pavarësisht nëse të njëjtat janë deklaruar në sistemin e Administratës Tatimore të Kosovës.

F. APLIKIMI PËR SUBVENCIONIM

7. Të drejtë aplikimi kanë shoqëritë tregtare të regjistruara dhe punëdhënësit sipas legjislacionit të Kosovës.
8. Aplikimi bëhet përmes sistemit elektronik EDI të Administratës Tatimore të Kosovës përmes formularit të veçantë që është i qasshëm në EDI.
9. Aplikimi mbetet i hapur deri më 15.10.2021.

G. APROVIMI DHE FINALIZIMI I LISTËS SË PËRFITUESVE

10. Lista finale e të kualifikuarve si përfitues nga masa konfirmohet nga Administrata Tatimore e Kosovës.

11. Mjetet buxhetore të nevojshme për zbatimin e masës do të ndahen me vendim të veçantë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përkatësisht programi Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës.
12. Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, listën finale me shumën totale të aprovuar, pas regjistrimit të shpenzimit në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës e procedon tek Thesari për ekzekutim në baza mujore, në pajtim me pikën 1 të këtij vendimi. Lista përfundimtare përgatitet pas datës pesëmbëdhjetë (15) të muajit vijues.

H. ZBATIMI I VENDIMIT PËR SUBVENCIONIM

13. Pas aprovimit të listës së përfituesve, alokohet buxheti dhe procedohen pagesat e subvencionimit në llogari bankare të punëdhënësit/shoqërisë tregtare.
14. Obligohen Administrata Tatimore e Kosovës, Agjencia e Punësimit e Kosovës dhe Thesari i Kosovës, për zbatimin e plotë të këtij vendimi.

I. HYRJA NË FUQI

15. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Vendimi ju dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të MFPT-së;
- Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit;
- Drejtorit të Përgjithshëm të APRK-së; dhe
- Arkivit.